

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

"Mega Store 2024" sh.p.k

Mbi bazën e kërkesave të ligjit Nr. 9901 te datës 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr. 9723 te datës 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Sot më 23.10.2024 krijohet shoqëria tregtare "Mega Store 2024" sh.p.k. me ortakë,

1. Znj. Anisa Mustaj, shtetase shqiptare, lindur më 25.06.1992 në Trevllazër, Vlorë - Shqipëri me kartë identiteti me nr. J25625057C , me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. Znj. Arjola Danaj, shtetase shqiptare, lindur më 03.09.1991 në Klos, Elbasan - Shqipëri, me kartë identiteti me nr. J15903008L, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KAPITULLI I

EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI

Neni 1

Emri

- 1.1. Shoqëria do të quhet **"Mega Store 2024"** ne logo me emrin tregëtar **"Mega Store"** . (Këtu e më poshtë "Shoqëria")
- 1.2. Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 1.3. Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare.



Neni 2

Selia

2.1. Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në Rruga Hajredin Haxhiraj 1214, zona kadastrale 8603, Rajoni Nr. 3, Pallati Turi MZB, lagja 28 Nentori, Vlorë, Shqipëri. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie apo degë si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është me afatë të Pakufizuar.

Neni 4

Objekti

4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është ai i importit, eksportit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve dhe aksesorëve shtëpiak, tekstile, veshmbathje, kozmetikë, pastrues dhe detergjent shtëpiak, sportiv, industrial, vegla pune, lodra dhe çdo produkti tjetër Joushqimor.

4.2. Shoqëria gjithashtu do të:

(i) kryejë çdo aktivitet me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme (përfshirë por pa u kufizuar në blerjen, shitjen, e marrjen dhe dhënien me qira të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme) si edhe aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë dhe më tej;

(ii) blejë, apo fitojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt (objekti i aktiviteti) të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj;

(iii) kryejë aktivitete publikimi, marketingu e reklamimi;

(iv) të kryejë aktivitete të ndërtimit, konstruksionit, projektimit, duke marrë licensat përkatëse;



(v) kryejë aktivitete import - eksporti të mallrave dhe/apo shërbimeve sipas nevojave të saj;

(vi) kryejë aktivitete për shitjen me pakicë apo shumicë të mallrave, pajisjeve siç do të konsiderohet e përshtatshme, të hapë pika shitjeje, apo të krijojë një zinxhir pikash shitjeje;

(vii) marrë apo të japë frangizë, licenca, marrëveshje administrimi, apo menaxhimi me palë të treta; dhe kryejë të gjitha dhe çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.

(viii) marrë pjesë në aktivitete, gara, tendera dhe partneritete publike në rrespekt dhe brenda ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

4.3 Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj të aktivitetit dhe/ose që lidhet me objektin e saj.

4.4 Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse në Republikën e Shqipërisë dhe standardet më të mira etike.

4.1.1 Shoqëria me vendim të Asamblesë së Përgjithshme mund të ndryshojë objektin e aktivitetit të saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR

NENI 5

Kapitali i themelimit dhe Ortakët

5.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 500,000.00 Lekë (pesqindë mij) Lekë, i ndarë në dy (2) kuota, të cilat janë në pronësi dhe zotërohen nga ortakët e Shoqërisë, si më poshtë:

- Znj. Arjola Danaj, zotëron një kuotë, e barabartë në vlerën 250,000.00 (dyqind e pesëdhjet mij) lekë, e cila përfaqëson 50.00 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, dhe i jep të drejtën e 50 votave.
- Znj. Anisa Mustaj, zotëron një kuotë, e barabartë në vlerën 250,000.00 (dyqind e pesëdhjet mij) lekë, e cila përfaqëson 50.00 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, dhe i jep të drejtën e 50 votave.

5.2. Ortakët e Shoqërisë marrin vendime në lidhje me zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë në përputhje me dispozitat e detyrueshme të Ligjit Tregtar Shqiptar dhe me dispozitat e këtij Statuti.

5.3. Kapitali mund të zmadhohet me kontribute në para apo në natyrë si edhe përfshirë rezervat apo fitimet e pashpërndara të Shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

NENI 6

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

6.1 . Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen apo kalohen në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar dhe këtij Statuti.

6.2. Ortakët mund të transferojnë kuotën e tyre apo pjesë të saj tek të tretët vetëm nëse bien dakord që të transferojnë secili pjesë të barabarta të kuotës përkatëse tek persona të tretë, në mënyrë që përqindja e pjesëmarrjes të secilit prej tyre në kapital pas transaksionit të jetë në çdo rast e barabartë. Asnjë prej ortakëve nuk mund të tjetërsojë kuotën e tij apo pjesë të saj në kundërshtim me këtë dispozitë dhe çdo veprim juridik i kryer në kundërshtim me këtë parashikim është i pavlefshëm.

6.3. Nëse një Ortak individ vdes, trashëgimtarët e tij ligjorë janë të vetmit persona të cilët Shoqëria i pranon si titullarë të kuotës së tij. Në të kundërt, e drejta e trashëgimtarit likuidohet nga Shoqëria.

NENI 7

Të drejtat dhe Detyrimet e Ortakëve

7.1 . Kapitali i regjistruar i Shoqërisë zotërohet tërësisht nga Ortakët e Shoqërisë.

7.2. Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë, të cilët kanë të drejtën e votës në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve, votë e cila është e barasvlershme me përqindjen që secili prej tyre zotëron në kapitalin e Shoqërisë, sipas nenit 5.1 të këtij Statuti, dhe që i jep të drejtën Ortakëve të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet qeverisëse vendimmarrëse të Shoqërisë, të marrin pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë (sipas dispozitave të këtij Statuti dhe atyre ligjore) si edhe të gjitha të drejtat e tjera që parashikohen në këtë Statut, apo në Ligjin Tregtar.

7.3. Detyrimet e Shoqërisë garantohen nëpërmjet kapitalit të saj dhe Ortakët e saj mbajnë përgjegjësi vetëm deri në vlerën e pjesëmarrjes së tyre në kapitalin e Shoqërisë; Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi përtej vlerës së pjesëmarrjes së tyre në kapitalin e Shoqërisë (me përjashtim të rastit të dorëzansisë për garantimin e huave apo të detyrimeve të tjera të Shoqërisë).

7.4. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe apo detyrimet personale të Ortakëve.



NENI 8
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Kompetencat dhe Vendimet e Ortakëve

8.1 . Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë, është organi më i lartë vendimmarrës dhe i kontrollit të Shoqërisë e cila merr vendime në lidhje me aktivitetin e saj dhe politikat ekonomike dhe tregtare të saj.

8.2. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme në përputhje me Ligjin Tregtar dhe këtë Statut:

- (a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- (b) ndryshimet e Statutit; emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- (d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- (c) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- (d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- (f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- (g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- (h) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- (i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
- (j) miratimin e çdo vendimi apo transaksioni që angazhon shoqërinë në vlerën mbi 50,000 € (pesëdhjetë mijë Euro);
- (k) çështje të tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar.

8.3 Vendimet e ortakëve do të regjistrohen në “Librin e Vendimeve të Shoqërisë” që do të mbahet në selinë e regjistruar të Shoqërisë.



NENI 9

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

9.1. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret pranë selisë së Shoqërisë ose në çdo vend tjetër, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si edhe në mënyrë virtuale.

9.2. Administratori mund të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme kur ta mendojë të arsyeshme.

9.3. Asambleja e Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike, që i drejtohet secilit prej Ortakëve. Njoftimi duhet bërë secilit ortak, së bashku me pikat e diskutimit, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

9.4. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas parashikimeve të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë Ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht kërkesave statutore për procedurat e thirrjes se Asamblesë se Përgjithshme.

NENI 10

Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

10.1. Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të fillojnë, nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në Ligjin Tregtar.

10.2. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë mund të realizohen në mënyrë virtuale, nëpërmjet platformave elektronike dhe shënimet e mbledhjeve mund të ratifikohen nga sekretari i mbledhjes, apo një noter publik, apo nga vetë ortakët nëpërmjet nënshkrimit, qoftë ky nënshkrim edhe elektronik. Ortakët mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas përcaktimit të nenit 88-të Ligjit Tregtar.


10.3. Ortakët marrin vendime edhe nëpërmjet vendimeve qarkulluese me shkrim, pa qenë e nevojshme që ata të mblidhen fizikisht.

10.4. Administratori drejton punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe cakton një person për të mbajtur procesverbalin e zhvillimit të mbledhjes. Ortakët në çdo rast kanë të drejtë me shumicë të thjeshtë votash të zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 11

Përfaqësimi në Asamblenë e Përgjithshme

11.1. Secili Ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një Ortak tjetër apo nga një person i tretë.



11.2. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite

NENI 12

Vendimmarrja

12.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime në përputhje me kuorumin dhe shumicën e përcaktuar në nenet 86 dhe 87 të Ligjit Tregtar, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut.

12.2 Në rast të bllokimit të vendimmarrjes të Ortakëve për një çështje të shqyrtuar në rendin e ditës, çështja në fjalë do të vendoset si vijon sipas përcaktimeve të këtij neni 12.

12.3 Bllokimi: Një situatë bllokimi konsiderohet të ketë ndodhur kur një vendim është propozuar ose paraqitur për zgjidhje dhe nuk është zgjidhur në dy (2) mbledhje të njëpasnjëshme të Asamblesë së Përgjithshme që duhet të mbahen brenda dy (2) muajve nga dita kur çështja është diskutuar për zgjidhje në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, si rezultat i votave të pamjaftueshme pohuese (d.m.th. në favor të vendimit të propozuar) dhe/ose si rezultat i kuorunit të pamjaftueshëm.

12.4 Përpjekjet me mirëbesim. Ortaket angazhohen të bëjnë çmos për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mirëbesim dhe në mënyrë që të mos bllokojnë ose rrezikojnë ndryshe bashkëpunimin si dhe aktivitetin tregtar të Shoqërisë.

12.5 Veprimet zbutëse në një bllokim. Kur një bllokim ka ndodhur dhe për aq kohë sa ai mbetet i pazgjidhur, secili Ortak angazhohet të ndër marrë veprimet që mund të jenë të nevojshme për:

* të mos u angazhuar në marrjen e çfarëdo veprimi ose vendimi të njëanshëm në lidhje me çështjet në fjalë;

* të minimizojë çdo pasojë negative të një bllokimi të tillë për shoqërinë dhe të sigurojë që funksionaliteti i shoqërisë të mos ndikohet materialisht nga ky Bllokim; dhe të sigurojë që biznesi, asetet dhe detyrimet e shoqërisë të menaxhohen në përputhje me Ligjet në fuqi dhe aktet nënligjore.

12.6 Mënyra e vendimmarrjes në situatë bllokimi;



a. Ortaket do të caktojnë një ekspert të përshtatshëm për të analizuar çështjen që krijon mosmarrëveshje (më tej referuar si "Eksperti"). Eksperti do të zgjidhet nga një nga shoqëritë e mirënjohura të shërbimeve të kontabilitetit dhe auditit, ose zyre e mirënjohur ligjore, me kusht që kjo shoqëri të mos jetë aktualisht e angazhuar nga asnjë nga Ortakët, apo ndonjë prej palëve të lidhura me të në kohën e përzgjedhjes:

b. Nëse Ortaket nuk përzgjedhin dot një Ekspert të përbashkët brenda 10 (dhjetë) ditësh nga mbledhja e dytë për adresimin e bllokimit, atëherë secili ortak zgjedh Ekspertin e vet dhe të dy ekspertet së bashku caktojnë një palë të tretë të pavarur.

c. Vendimi i Ekspertit do të jetë i detyrueshëm për zbatim nga Ortakët. Kostot e ekspertit shlyhen nge Shoqëria.

12.7 Në rast dështimi të procedurës së ekspertit dy (2) here rresht ose për më shumë se katër (4) muaj, çështja do të zgjidhet nga Gjykata kompetente sipas përcaktimit në këtë Statut.

12.8 Procedura e parashikuar në pikat 12.3. — 12.7. më sipër nuk gjen zbatim në rastin e emërimit të Administratorit të shoqërisë, i cili në çdo rast zgjidhet sipas parashikimeve të nenit 13 të Statutit.

KAPITULLI I IV

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 13

Emërtimi i Administratorit

13.0. Ortakët emërojnë administrator të kompanisë Znj. Anisa Mustaj, shtetase shqiptare, lindur më 25.06.1992 në Trevllazër, Vlorë - Shqipëri me kartë identiteti me nr. J25625057C , me zotësi të plotë juridike për të vepruar; Administratori do të qëndroj në detyrë për një periudhë 5 vjeçare; nda data 23/10/2024 deri në datën 22/10/2029.

13.1. Shoqëria përfaqësohet dhe menaxhohet nga 1 (një) Administrator, apo më shumë, i cili zgjidhet dhe shkarkohet me votat e Ortakëve që përfaqësojnë shumicën e thjeshtë (mbi 50%) të kapitalit të shoqërisë (sipas përqindjes që secili ortakë zotëron në kapitalin e shoqërisë).

13.2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për aktivitetin e zakonshëm tregtar të shoqërisë me përjashtim të atyre çështjeve që parashikohen në këtë Statut, nga ligji i zbatueshëm apo vendimeve të ortakëve.



13.3. Administratori emërohet në detyrë për një afat prej 5 (pesë) vjetësh nga data e emërimit, me të drejtë ripërtëritje sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve, dhe ky afat fillon nga data e marrjes së Vendimit të Ortakëve të Shoqërisë.

13.5. Administratori është i veshur me pushtet për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, pa pasur ndonjë përjashtim të ndonjë lloji të veçantë dhe ka të drejtën për të përmbushur të gjitha veprimet që i konsideron të përshtatshme për zbatimin dhe arritjen e qëllimeve të shoqërisë, përjashtuar ato që Ligji Tregtar ia ka rezervuar Asamblesë së Përgjithshme.

13.6 Për sa i përket kompetencave sipas këtij neni, Ortakët përcaktojnë me vendim përkatës kufijtë e kompetencave, fushën e kompetencës të çdo administratori dhe nëse është e nevojshme edhe procedurat për mbledhjet e tyre të mundshme.

13.7. Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e të gjitha punimeve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.

13.8. Administratori do të mbikëqyrë dhe do të sigurohet se punëmarrësit, agjentët, punonjësit, auditorët dhe këshilltarët e Shoqërisë do të tregojnë kujdesin e duhur dhe në interesat më të mira të shoqërisë.

13.9. Përveç detyrave të përgjithshme dhe atribuuar sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit Tregtar, Administratori duhet:

- a) të kryejë detyrat e tij/saj në përputhje me Ligjin Tregtar, apo këtë Statut, me mirëbesim maksimal në interesat më të mira të Shoqërisë në tërësi e që përfshin qëndrueshmërinë mjedisore të aktiviteteve të saj;
- b) të veprojë në favor dhe mbrojë interesat e ortakëve të Shoqërisë, duke zbatuar parimet më të larta, me integritet dhe mbi baza të forta besueshmërie;
- c) të ushtrojë kompetencat që i jepen atij/asaj sipas ligjit apo këtij Statuti vetëm Për qëllimet e caktuara aty;
- d) ti japë rëndësinë e duhur çështjeve për miratim;
- e) të kryejë çdo veprim juridik në emër dhe për llogari të shoqërisë deri në vlerën EUR 50,000 (pesëdhjetë mijë Euro) dhe të njoftojë Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve për çdo vendimarrje të nevojshme mbi këtë vlerë;
- f) të sigurojë që Shoqëria është e shëndetshme dhe të ushtrojë kujdesin maksimal ndaj çdo risku;
- g) të tregojë kujdes dhe të përdorë aftësitë në mënyrë të arsyeshme në ushtrimin e detyrave të tij/saj.



13.10. Administratori mund të autorizojë individë persona të tretë për të vepruar për llogari të tij/saj dhe për të përfaqësuar Shoqërinë tek të tretët për çështje specifike për zgjidhje sipas vendimit të Ortakëve të Shoqërisë, vendim i cili mund të merret me shumicë të thjeshtë.

13.11. Administratori ka të drejtë të marrë shpërblim për punën e tij, i cili caktohet me vendim të zakonshëm dhe shumicë të thjeshtë votash të Asamblesë së Përgjithshme.

13.12. Administratorit ose bashkëpunëtorëve të tij u paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit ose shpenzime të tjera, që atyre u përkasin për pjesëmarrjen në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme ose mbledhje të veçanta, si edhe shpenzimet që lidhen me kryerjen e detyrave të tij.

KAPITULLI I V

VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPËRNDARJA E FITIMIT

NENI 14

Viti financiar

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Përfundimisht Viti i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

NENI 15

Inventari dhe llogaritë vjetore.

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore.

Në mbylljen e vitit financiar administratori harton inventarin e pasurisë, në këtë datë dhe llogaritë vjetore për vitin financiar .

NENI 16

Raportet vjetore

23.1 Në mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe Financieri harton inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortakët.

23.2 Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

23.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe financierit miratohen nga ortakët sipas Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".



NENI 17.

Librat Kontabël

Shoqëria do të mbajë kontabilitetin në monedhën shqiptare (LEK) dhe në monedhë të huaj si edhe do të përgatisë bilancin dhe pasqyrën e fitim-humbjeve sipas ligjit shqiptar.

NENI 18.

Shpërndarja e Fitimeve

Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të saj të miratuar nga Ortakët. Shpërndarja e fitimeve miratohet nga Ortakët. Me vendim unanim Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë shpërndarjen e fitimeve të shoqërisë në raport të ndryshëm nga ai i pjesëmarrjes së ortakëve në kapital.

KAPITULLI V

MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

NENI 19.

Mbyllja e Shoqërisë

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentabël gjatë tre viteve të fundit radhazi dhe kur për këtë ka vendosur gjykata kompetente.

NENI 20.

Caktimi i Likuidatorit

20.1 Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortakët caktojnë një likuidator, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban në krahë të emërtimit dhe emrin “Shoqëri në Likuidim e sipër”.

20.2 Likuidatori i emëruar nga ortakët menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe ta vendosi në dispozicion të menjëhershëm ortakëve.

20.3 Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë ekonomike.

NENI 21.

Mbyllja e Likuidimit

Ortakët vendosin mbi rregullshmërinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuidatorit.

Ortakët mund të vendosin vetë realizimin e kësaj mbyllje, në rast se likuidatori nuk e kërkon. Mbyllja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e ortakëve ose të një mandat mbajtësi të caktuar prej tyre.



DISPOZITAT KALIMTARE

NENI 22

Dispozitat e fundit

22.1 Për te gjitha çështjet qe nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008” Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

22.2 Për efekt të interpretimit të këtij Statuti me Ligjin Tregtar nënkuptohet Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare”

22.3 Pavlefshmëria eventuale e dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të çënojë vlefshmërinë e tij.

NENI 23

Gjykata kompetente.

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve dhe interpretimin e Statutit të Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

NENI 24

Hyrja në fuqi

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosje nga Ortaket.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

“ Mega Store 2024 “ sh.p.k.

Anisa
Arjola
Mustaj
Danaj

The image shows a document with handwritten signatures and names in blue ink. The names 'Anisa', 'Arjola', 'Mustaj', and 'Danaj' are written in a cursive style. To the right of these names are two distinct handwritten signatures, also in blue ink, which appear to be the signatures of the individuals named.